REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE,INFRASTRUKTURËS, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT**

Nr.2203311 Prot, Lezhë, me 10.11.2026

**RELACION MBI PROJEKT–VENDIMIN**
**"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI VENDOSJEN, SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE MENAXHIMIN E PENGESAVE TË KUFIZIMIT TË SHPEJTËSISË (KURRIZET ARTIFICIALE) NË TERRITORIN E BASHKISË LEZHË"**

Ky projekt–vendim paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak Lezhë në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" Ligji Nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 153, datë 7.4.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, bazuar në kërkesat e shumta të paraqitura nga banorët dhe nga vlerësimet teknike të kryera nga strukturat kompetente e Bashkisë Lezhë. Nga verifikimet e kryera në terren është konstatuar se në disa segmente rrugore qarkullimi i mjeteve zhvillohet me shpejtësi të lartë, duke krijuar rrezik potencial për jetën e banorëve. Kjo situatë ka sjellë shqetësime të vazhdueshme në komunitet dhe ka bërë të domosdoshme ndërhyrjen e autoritetit vendor me masa konkrete parandaluese, në funksion të rritjes së sigurisë rrugore. Vendosja e kurrizave artificiale përbën një nga masat më efektive për kufizimin fizik të shpejtësisë së mjeteve, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e rrezikut të aksidenteve dhe në krijimin e kushteve më të sigurta për qarkullimin e këmbësorëve. Kjo ndërhyrje është në përputhje me standardet teknike dhe rregullat e sinjalistikës rrugore, duke garantuar njëkohësisht funksionalitetin e infrastrukturës dhe sigurinë e përdoruesve të saj. Realizimi i këtij projekti pritet të sjellë një sërë përfitimesh për komunitetin, duke përfshirë rritjen e nivelit të sigurisë rrugore, uljen e rasteve të shkeljeve të kufijve të shpejtësisë, minimizimin e rrezikut të aksidenteve, mbrojtjen e jetës të qytetarëve, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës në zonat e banuara. Gjithashtu, kjo masë do të ndikojë pozitivisht në rritjen e ndërgjegjësimit të drejtuesve të mjeteve për respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor. Duke qenë se garantimi i sigurisë së qytetarëve dhe administrimi i infrastrukturës rrugore përbëjnë një nga funksionet themelore të njësisë së vetëqeverisjes vendore, miratimi i këtij projekt-vendimi vlerësohet si një ndërhyrje e nevojshme, e arsyeshme dhe në interes të drejtpërdrejtë publik.

**KRYETARI**
**Pjerin NDREU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LEZHË